



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 78, datë 23.05.2014

MBI

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 55, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 20 (pika 20.1) të statutit të shoqërisë së sigurimit “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a., tekstit më poshtë:

“Neni 20

Përbërja dhe emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

20.1 Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga një numër anëtarësh nga 3 (tre) deri në 7 (shtatë). Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktohen nga Asambleja e Aksionarëve në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar mbi kufizimet e emërimit. Këshilli Mbikëqyrës do të veprojë në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar, me këtë statut si dhe me Rregulloret e Brendshme të Këshillit Mbikëqyrës, të cilat hartohen dhe miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës”.

2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI